



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo administracija lokalne samouprave

Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 07.09.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, NR.7/01, Mars 2019), Shtojcën I-(9) të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ligjin Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, si dhe bazuar në nenin 8 të Rregullores Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve, nxjerr:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni vlerësues për vlerësimin e aplikimeve të OJQ-ve, sipas thirrjes publike për mbështetje financiare për projekt/programet e organizatave jo-qeveritare në fushën e "Auditimit social në nivel lokal", të datës, 11.08.2023.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1 Flurim Arifi, kryesues;
 - 2.2 Edina Ibishi, anëtar;
 - 2.3 Ganimete Salihu, anëtar;
 - 2.4 Ferid Murseli, përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar;
 - 2.5 Jeton Krasniqi, përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar;
 - 2.6 Zijadin Biqkaj, anëtarë rezervë.
3. Komisioni është përgjegjës të bëjë vlerësimin e aplikimeve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike për OJQ për implementimin e projektit "Auditimi social në nivel lokal", të datës, 11.08.2023, dhe Rregulloren Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Jeton Qela

Zv. Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, MAPL;
- Anëtarëve të komisionit;
- Arkivit në MAPL.